

Përmbledhje

Gazetarin serb Vladimir Mitriq gjithmonë e ka tërhequr zbulimi i anës së errët të jetës: trafiku i njerëzve dhe i drogës; krimet e luftës; politikanët e korruptuar, përfituesit e luftës, tajkunët dhe vrasësit e mbuluar nga institucionet shtetërore – një lloj pune që të armiqëson me shumë njerëz.

Në 2005 Mitriq ishte duke investiguar trafikun e drogës përgjatë lumit Drina, një rrip uji 346 km që përbën më së shumti kufirin ndërmjet Bosnjë Hercegovinës dhe Serbisë. Në 12 shtator ai ishte duke hyrë në shtëpinë e tij në Shabac, në Serbinë perëndimore, kur një ish polic e sulmoi me një shkop bejzbolli në prapun e shtëpisë, duke e goditur më shumë se 20 herë në kokë, në shpatulla dhe shpinë për t'u larguar më pas qetësisht nga vendi i ngjarjes. Incidenti ndodhi pak metra larg një kafeneje plot me klientë. Shumë prej tyre ishin polica jashtë detyre, askush nuk iu përgjigj thirrjes së Mitriqit për ndihmë.

Kur Mitriqi iu drejtua policisë në 2004 për të parë se si po ecnin hetimet mbi tre incidentet e mëparshme ku u dëmtuar makina e tij, kreu i policisë së qytetit të tij i'u përgjigj: "Ç't'i bësh, ti ke një profesion të vështirë."

Që atëherë Mitriq – i cili ka qenë viktimë e disa sulmeve të tjera përpara incidentit të shtatorit – ka qenë nën mbrojtjen e policisë, edhe pse vetëm në zonën e kufizuar të Shabacit. Sulmuesi u dënua me një vit burg: u anulua para se të arrinte fazën e apelit falë një amnistie të përgjithshme.

Zbulime

Në bazë të intervistave të thelluara me gazetarët, redaktorët dhe pronarët e mediave, ky raport dokumenton ambientin e dhunshëm në të cilin gazetarët si Mitriqi punojnë në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi.

Gazetarët dhe redaktorët e intervistuar për këtë raport përshkruan një hapësirë mediatike të vështirë në të cilën ata përballen me kërcënime, sulme, dhe lloje të tjera presionesh dhe ndërhyrjesh në punën e tyre. Ata përshkruajnë kërcënime të vazhdueshme të drejtëpërdrejta dhe të indirekte, kundër tyre dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, sulme fizike ndaj tyre dhe vendeve të tyre të punës, dhe madje edhe kërcënime për vdekje.

Shumë prej incidenteve të dhunës dhe kërcënimeve të dokumentuar në këtë raport ishin të adresuar kundër gazetarëve, në veçanti ndaj atyre që shkruajnë për biznesin e fuqishëm dhe elitat politike, ose që raportojnë për krime lufte, korrupsion të nivelit të lartë dhe mbi grupet fetare radikale. Sulme dhe kërcënime mund të sjellin si rezultat vetë-censurë si edhe krijimin e një gjendjeje padënueshmërie për krimet kundër gazetarëve.

Nuk ekzistojnë statistika të besueshme, të diferencuara e zyrtare mbi krimet e zakonshme dhe krimet kundër gazetarëve. Sidoqoftë, në vitet e fundit organizata jo qeveritare kanë monitoruar sulmet dhe kërcënimet kundër gazetarëve.

- Bosnjë Hercegovinë: 20 raste sulmesh ose kërcënime kundër gazetarëve në Bosnjë Hercegovinë, duke përfshirë 5 raste sulmesh fizike, 14 raste kërcënimesh dhe presionesh dhe një kërcënim për vdekje gjatë shtatë muajve të parë të 2014, sipas Shoqatës të gazetarëve të Bosnjë Hercegovinës. Human Rights Watch dokumentoi dy raste përdorim të tepërt dhune nga ana e policisë kundër gazetarëve që raportuan mbi protestat e shkurtit 2014 në Bosnjë.
- Kosovë: 22 raste dhune fizike dhe kërcënime kundër gazetarëve në Kosovë mes janarit dhe nëntorit 2014, sipas Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (APJK) që nga 2013. Një rast përfshiu një gazetar të goditur me armë të ftohta në Prishtinë nga fundi i 2014 nga një burrë të cilin ai kishte satirizuar në një show televiziv në kanalin privat Klan Kosova.
- Serbia: 28 raste sulmesh fizike, kërcënime, dhe lloje të tjera presioni kundër gazetarëve mes janarit dhe gushtit 2014, duke përfshirë 5 sulme fizike dhe tre kërcënime me vdekje, sipas Shoqatës së pavarur të gazetarëve (NUNS) pak a shumë, njësoj si në 2013. Një gazetar serb u rrah në Korrik 2014 nga tre burra dy here brenda një nate mes konfrontimesh etnike.
- Mali i Zi: 20 raste sulmesh dhe kërcënime kundër gazetarëve malazezë mes 2010 dhe fillimit të 2014, duke përfshirë shpërthime pranë mediave dhe makina bombë, sulme dhe kërcënime për vdekje, sipas Human Rights Action (HRA), një organizate lokale joqeveritare. Për shembull e përditshmja malazeze Vijesti pësoi një shpërthim jashë zyrave të saj nga fundi i 2013.

Gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të sulmeve kibernetike ndaj websiteve të lajmeve pas publikimit të artikujve kritike, veçanërisht në Serbi dhe në Republika Srpska e në Bosnjë Hercegovinë. Gazetarët kanë raportuar një numër në rritje kërcënimesh të bëra online dhe nëpër mediat sociale, shpesh në lidhje me punën mbi grupet radikale. Për shembull që nga 2012, kur filloi të raportonte për Islamin radikal, Artan Haraqija, një gazetar freelance në Kosovë, ka marrë qindra kërcënime në Facebook. Edhe pse në fillim nuk ia raportoi policisë, filloi t'i denonconte ato kur mori kërcënime për vdekje në Facebook në shtator 2014.

Mosndëshkimi, mungesa e veprimit

Studimi i Human Rights Watch zbuloi se reagimi jo efektiv i shtetit ka sjellë si rezultat një mosndëshkim de facto për pjesën më të madhe të krimeve kundër gazetarëve.

Gazetarët të cilët i raportuan policisë kërcënime dhe sulme përshkruan hetime policore sipërfaqësore; nënvlerësim të sulmeve të dhunshme dhe kërcënimeve kundër gazetarëve; dhe hetime që rrallëherë sjellin identifikimin e autorëve të ngjarjeve.

Në disa raste gazetarëve thanë se ata kanë vazhduar të pësojnë dhunë fizike dhe abuzime pas sulmit fillestar, duke u hasur shpesh dhe përsëri me mosndëshkim të sulmuesve.

Gazetarët që kanë raportuar për krimet e luftës dhe grupet fetare radikale në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi, thanë se autoritetet nënvlerësuan seriozitetin e kërcënimeve online që kishin marrë.

Në rastet e pakta në të cilat autorët u identifikuan, gazetarët thanë se autoritetet dështuan në hetimin e motiveve potenciale të sulmeve apo kërcënimeve apo vazhdimin e ndjekjes penale. Rastet që përfunduan me dënime, në përgjithësi u përbënë nga dënime të ulëta.

Mungesa e efencës dhe prapambetje të theksuara në katër sistemet e drejtësisë pengojnë gjykimin e rasteve ligjore. Rastet shtyhen për vite, duke krijuar një ambient i cili mund të përdoret në avantazh të atyre që kërkojnë të pengojnë raportimin kritik nëpërmjet akteve kriminale dhe presioneve.

Ndërhyrje politike dhe presion financiar

Interferenca politike dhe presioni financiar ndaj mediave dhe gazetarëve, si në nivel kombëtar edhe në nivel lokal është një problem serioz në Ballkanin perëndimor.

Gazetarët i thanë Human Rights Watch, se në disa raste politikanët u bënë presion pronarëve dhe redaktorëve të heqin dorë nga artikujt kritikë. Më depërtuese janë përpjekjet nga ana e zyrtarëve publikë për të penguar mediat kritike nëpërmjet presioneve financiare, ose duke prerë (apo kërcënuar të presin) financimet shtetërore, ose duke kufizuar reklamën shtetërore.

Për më tepër, gazetarët në të katër vendet e Ballkanit Perëndimor, të mbuluar në këtë raport, thanë se janë paditur rregullisht, përfshirë këtu edhe nga zyrtarë të rangjeve të larta në nivel lokal dhe kombëtar, duke i penguar t'i kushtojnë kohë gazetarisë, dhe duke u detyruar në disa raste të paguajnë gjoba dhe dëmshpërblime me urdhër gjykatë. “Në vend që të të godasin në kokë, ata (qeveria) të godet në kuletë,” tha një redaktor gazete nga Mali i Zi.

Gazetarët në Bosnjë Hercegovinë dhe Serbi gjithashtu thanë se zyrtarët e qeverisë kanë kryer inspektime arbitrare financiare pa paralajmërim paraprak dhe kontrole të dokumentave administrative, si protokolle të zjarrit duke kërcënuar apo bërë presion për raportim kritik, si për shembull për rastin e një sërë artikujsh mbi një çështje delikate ku ishin përfshirë zyrtarë të lartë të vjetër.

Një kryeredaktor në Serbi përshkroi se si pas 19 vjetësh pa asnjë problem fiskal me autoritetet, gazeta e tij pati një inspektim surprizë para dy vjetësh, jo shumë kohë pasi media filloi të botonte një seri artikujsh kritikë në lidhje me liderët politikë (të qeverisjes lokale në Nish, Serbi).

Inspektori u shfaq pa asnjë lajmërim. Ai kërkoi të shihte dokumente mbi mbrojtjen ndaj zjarrit, të cilat janë të nevojshme vetëm për kompanitë me më shumë se 10-të punësuar edhe pse në kemi vetëm 3 të tillë. Ai gjithashtu donte të kontrollonte nëse kishim një tabelë kundër pirjes së duhanit.

Inspektimet mund të zgjasin disa javë, duke i penguar gazetarët të zhvillojnë punën e tyre. Për sa është në dijeni Human Rights Watch, asnjë media nuk është gjobitur për shkelje rregulloresh të rëndësishme.

Gazetarë dhe media të pavarura përshkruan gjithashtu se kanë pësuar fushata njollosjeje nga mediat pranë qeverisë, me artikuj që përcaktonin gazetarët kritikë si tradhëtarë të kombit apo duke i poshtëruar ata me karikatura. Në disa raste artikujt mbi gratë gazetare përdorin imazhe vulgare dhe një gjuhë seksualisht fyese.

Në disa raste zyrtarë të rangjeve të larta marrin pjesë aktivisht në këtë njollosje publike të gazetarëve. Kryeministri i Malit të Zi, Millo Gjukanoviq dhe kryeministri i Serbisë Aleksandar Vuçiq kanë akuzuar publikisht gazetarët për veprim në interes të të huajve. Një konferencë rajonale për gazetarinë në Ballkanin Perëndimor mbajtur në nëntor 2013, paraqiti një ekspozitë publike fotografish në të cilën tre media të pavarura në Malin e Zi paraqiteshin si armike të shtetit.

Detyrimet

Situata për gazetarët dhe mediat në shumë vende të Ballkanit Perëndimor është shqetësuese – një situatë që ka pasoja të rënda për mediat dhe gazetarët, por edhe më gjerë për shoqërinë në tërësi.

Si gur themeli i një shoqërie demokratike, mediat e lira dhe të pavarura lehtësojnë qarkullimin e lirë të ideve, opinionëve dhe informacionit të nevojshëm për funksionimin e proceseve politike, dhe shërbejnë si kontroll kritik për autoritetet zbatuese.

Bosnjë Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia kanë detyrime të qarta përkundrejt të drejtave të njeriut në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për të respektuar dhe mbrojtur lirinë e shprehjes, lirinë e medias, dhe pluralizmin e medias. Për më tepër, kriteret e Kopenhagenit në lidhje me shtetet që janë duke negociuar me BE për anëtarësim – gjë që e aspirojnë të katra këto vende – përfshijnë edhe respektimin e lirisë së medias.

Reagimi i papërshtatshëm i shtetit ndaj sulmeve dhe kërcënimeve kundër gazetarëve dhe mediave, ndërhyrja politike nëpërmjet gjykatave dhe uljen e financimeve, dhe fushatat e përvojimit kundër mediave kritike dhe gazetarëve, tregojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor të paraqitura në këtë raport nuk po përmbushin obligimet rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Autoritetet relevante në katër vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshira në këtë raport duhet të ndërmarrin hapa të menjëhershme për të siguruar që gazetarët të kryejnë punën e tyre në mënyrë të sigurtë dhe pa ndërhyrjen e papërshtatshme të qeverisë apo të palëve të treta. Si pjesë e kësaj ata duhet të ndërmarrin hetime të menjëhershme dhe efektive ndaj krimeve kundër gazetarëve dhe të vënë para drejtësisë personat përgjegjës. Zyrtarët e rangut të lartë duhet të pushojnë së ndërhyri në media dhe duhet të dënojnë publikisht krimet kundër gazetarëve. Ata gjithashtu duhet të fillojnë të regjistrojnë krimet kundër gazetarëve, duke qenë se pa statistika zyrtare është e vështirë për autoritetet të përcaktojnë natyrën e problemit dhe të veprojnë në mënyre efektive.

Rekomandime

Autoriteteve të Bosnjë Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë

Për Krerët e Shteteve

- Të dënohen publikisht dhe në mënyrë të pakontestueshme gjithë sulmet kundër gazetarëve dhe mediave dhe të sigurohen hetime të menjëhershme dhe të plota të të gjitha këtyre incidenteve;
- Të sigurohet një ambient në të cilin profesionistët e medias të jenë të lirë nga presionet, duke përfshirë akuzat e të qenit agjentë të huaj apo tradhëtarë të vendit;
- Të sigurohet se politikanët dhe zyrtarët e qeverisjes e në të gjitha nivelet të ndalin së abuzuari paketat ligjore mbi përgojimin civil kundër gazetarëve.

Ministrive të brendshme

- Të dënohen publikisht dhe qartë të gjitha sulmet kundër gazetarëve dhe mediave;
- Të sigurohet që policia të hetojë menjëherë të gjitha sulmet dhe kërcënimet e besueshme kundër gazetarëve dhe mediave, dhe të sigurohet se për çdo zyrtar, oficer policie apo të tjerë përgjegjës për obstrukcion, abuzim apo sulm ndaj gazetarëve, të merren masat apo të hetohen;
- Të sigurohet ndihma e nevojshme financiare dhe teknike për të siguruar trajnimet e duhura për policinë në hetimin e krimeve kundër gazetarëve;
- Të sigurohet se gazetarët që përballen me kërcënime të veçanta dhe të cilët kërkojnë mbrojtje, t'u jepet kjo e fundit.

Hetuesve dhe Gjyqësorit

- Të kryhen hetime tërësore, të paanshme, efektive dhe të menjëhershme, për gjitha sulmet dhe kërcënimet kundër gazetarëve dhe mediave duke përfshirë krimet e internetit, dhe të kryhen ndjekja penale sic duhet.

Institucioneve të Bashkimit Evropian, dhe Vendeve Anëtare

- Si pjesë e monitorimit të përputhshmërisë me kushtet e anëtarësimit në BE në përgjithësi, dhe kapitullit 23 në veçanti, Komisioni European duhet të sigurojë se respektimi i lirisë së shtypit është një parakusht kyç për anëtarësimin në BE dhe të theksojë rëndësinë e përmirësimit të situatës për gazetarët dhe klimën për lirinë e medias duke dialoguar me shtetet e Ballkanit Perëndimor gjatë fazave të ndryshme të negociimit për anëtarësim në BE;
- Të përdoret çdo mundësi për tu kërkuar autoriteteve kompetente në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi të ndalin menjëherë të gjitha presionet ndaj gazetarëve dhe mediave dhe të ndërmerrin hapat e nevojshme për të përmirësuar hetimet e sulmeve dhe kërcënimeve kundër gazetarëve, si edhe të sjellë autorët e tyre para drejtësisë.

Organizatës për Siguri dhe Kooperacion në Europë (OSCE)

- Përfaqësuesit e OSCE-s për lirinë e medias duhet të vazhdojnë të theksojnë rastet e dhunimit të lirisë së medias dhe vështirësitë e gazetarëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor si pjesë të punës së tyre, dhe të bëjnë rekomandime konkrete për hapat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve të gjetura;
- Organe të tjera të OSCE-s dhe të shteteve pjesëmarrëse duhet t'u kërkojnë autoriteteve kompetente në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi, të hetojnë tërësisht dhe procesojnë gjithë rastet e sulmeve dhe kërcënimeve duke përfshirë ato online, kundër gazetarëve dhe mediave për të sjellë autorët e tyre para drejtësisë;
- Të sigurojë ndihmë teknike dhe mbështetje tjetër për autoritetet kompetente në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi, në promovimin e lirisë së medias dhe mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve;
- T'u kërkojë autoriteteve kompetente në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi të garantojnë transparencën e pronësisë së mediave dhe të luftojnë rrezikun në rritje të presioneve të papërshtatshme ndaj redaktorëve dhe gazetarëve.

Këshillit të Europës (CoE)

- Sekretari i Përgjithshëm, Komisioneri për të drejtat e njeriut, Asambleja Parlamentare dhe organe të tjera kompetente të CoE-së, duhet ta kenë prioritet lirinë e medias në punën e tyre në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar problemet e dokumentuara në këtë raport dhe duke kërkuar hapa konkrete për të zgjidhur mangësitë e gjetura;
- Në veçanti organet e CoE duhet t'u kërkojnë autoriteteve kompetente në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi, të garantojnë hetime të plota dhe ndjekje penale të të gjitha rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve kundër gazetarëve dhe mediave, për të sjellë përgjegjësit e tyre para drejtësisë dhe të qartësojnë se dhuna dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe mediave nuk do të tolerohet;
- Të theksojnë se masat për krimet kundër gazetarëve reflektojnë seriozitetin e shkeljeve nga ana e autoriteteve kompetente në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi;
- Të bashkëpunojë me autoritetet kompetente në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi, për të nxitur debatin se politikanët dhe zyrtarët qeverisës duhet të pranojnë më shumë kritikizëm publik dhe vrojtim duke përfshirë atë nga ana e gazetarëve;
- Të ndërmarrin misione monitoruese kur është e nevojshme për të parë veçanërisht lirinë e mediave në Ballkanin Perëndimor.